



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***12 Janar 2016***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Projekti "Fondi kujdeset për të sëmurët kronik" zhvillohet sipas planifikimit

Realizimi i projektit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, "Fondi kujdeset për të sëmurët kronik" dhe rezultatet më të reja nga thirrjet e të punësuarve nga Fondi në lidhje me kujdesin për të sëmurët kronik të cilët deri më tani kontaktuan 19.214 të siguruar me diabet, sëmundje kardiologjike dhe të veshkave, zhvillohen sipas dinamikës së planifikuar...



Nga Fondi për sigurim shëndetësor të Maqedonisë kumtuan se nga përvoja e deritanishme të 10 ekipeve të punësuar në Fond, të cilët i kanë kontaktuar të siguruarit se vazhdojnë të hasin në pranim pozitiv të të siguruarit të cilët i kontaktojnë.

Edhe pse nga thirrjet e deritanishme duket se të siguruarit janë të njoftuar me rëndësinë e sëmundjes së tyre dhe kanë informacione bazë për terapinë e tyre, mënyrën e të ushqyerit dhe stilin e jetesës, megjithatë theksojnë nga Fondi, disa të siguruar të cilët edhe pse kanë qenë në dijeni se janë të sëmurë, nuk kanë qenë të sigurt cilat janë pasojat nga shkuarja në kohë në mjek dhe marrja e terapisë së nevojshme. Megjithatë,



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



pas informimit nga të punësuarit nga FSSHM, këta të siguruar janë dakorduar që me më shumë përkushtim të sillen ndaj shëndetit të tyre dhe t'i dëgjojnë rekomandimet e mjekëve.

Nga Fondi informojnë se të siguruarit të nxitur nga thirrjet e punonjësve të tyre janë interesuar edhe për të drejtat tjera nga sigurimi shëndetësor, të cilët janë në kompetencë të Fondit, siç janë realizimi i pajisjeve ortopedike, e drejta e rehabilitimit mjekësor si mjekim i vazhduar spitalor dhe kërkuan informacione shtesë për ilaçe në listën pozitive.

Ekipet janë të përbëra nga të punësuar nga shërbimet më të mira rajonale, siç janë: Shkupi, Shtipi, Manastiri, Strumica, Velesi, Prilepi dhe Kumanova. Ata iu paraqiten të siguruarve me tre sëmundjet kronike që t'i përkujtojnë se cilat kontrole duhet rregullisht t'i bëjnë për t'i informuar për kompleksitetin e sëmundjes, me qëllim të ndalohet progresioni i mundshëm i sëmundjes, qëndron në kumtesën e FSSHM-së. (mia.mk)



## Maqedonia kursen në llogari të personave me diabet

**Shkup, 11 janar** – Maqedonia po kthehet një hap mbrapa me eksportin e insulinës. Sipas shoqatave të të sëmurëve me diabet vendi ynë po bën disa gabime në këtë drejtim pasi që nuk furnizon sa duhet të sëmurët me preparate.

Madje, supozohet se eksportohen aparate kineze të cilat nuk e masin saktë sheqerin në gjak, ka mungesë gjithmonë të insulinës ose eksporton insulin të dyshimtë që nuk ndikon aspak në uljen e sheqerit, njofton Zhurnal.

Për këtë problematikë e cila dita ditës po bëhet gjithnjë e më aktuale dhe me të cilat përballen qytetarët në vendin tonë dhe për këtë temë është biseduar në emisionin Proces ku të ftuar kanë qenë Boban Nestorovski nga shoqata BUV dhe Cvete Serafimoski nga shoqata e personave me diabet, Balans Mk.

## Nga janari bazë më e ulët e pensioneve invalidore

**Shkup, 11 janar** – Nga ky muaj baza e pensionit invalidor do të jetë më e vogël. Në vend që 80% nga rroga me përvojë të plotë pensioni nga viti 2016 cdo vit do të ulet për 0.32% në vit. Deri në vitin 2040 do të bie deri në 72%.

Kjo do të thotë se punëtorët që do të punojnë përvojë të plotë (35 vjet burrat dhe 30 vjet gratë) nëse pensionohen si invalid në vend që të marin 80% do të marin pension në masën 72% nga rroga, njofton Zhurnal.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Nga ministria e punës dhe politikës sociale theksojnë se bëhet fjalë për ndryshime të ligjit të bëra në vitin 2000 kur edhe është krijuar koncepti i sistemit pensional me disa ndryshime për këtë vit. Me sistemin e ri vërtetohet se pensionin invalidor do ta paguaj vetëm fondi pensional.

## Prindërit vaksinojnë fëmijët kundër Streptokokit

**Shkup, 11 janar** – Shumë prindër janë të interesuar që fëmijët e tyre t'i vaksinojnë dhe t'i mbrojnë ndaj infeksionit të virusit dhe bakteries streptokok pneumoni pasi që nga shtatori është vendosur si vaksinë në shtëpitë e shëndetit.

Mbrojtja ndaj këtij virusi parashihet për fëmijët deri në 5 vjet vecanërisht ato që frekuentojnë cerdhet pasi që kjo vaksinë jep shumë imunitet ndaj sëmundjeve.

Mjekët këshillojnë që këtë vaksinë e cila është pa pagesë por jo e detyrueshme të mbrohen të drejtat e fëmijëve që shkojnë nëpër parashkollore apo cerdhe, informojnë se shumë prindër tashmë janë të interesuar të vaksinojnë fëmijët e tyre.

“Me rëndësi është që fëmijët kur të marin vaksinën të jenë të shëndoshë dhe të mos kenë temperaturë apo simptoma të gripit. Vaksina ka mjaftueshëm dhe nuk ka nevojë të bëjnë termine tek mjekët amë. Imuniteti që e marin fëmijët nga kjo vaksinë është më i fortë”, theksojnë nga reparti pediatrik.

**PORTALB**  
dritare realiteti

## Maqedoni, filloi sezoni: Përhapet “Variçela” te fëmijët, s’ka nevojë për panic



“Variçela” është njëra nga sëmundjet më të shpeshta infektive te fëmijët. Virusi ngjitet nga njëri te tjetri nëpërmjet frymës – nëpërmjet kollitjes, teshtimës, po edhe nëpërmjet të folurit. Kur fëmijët janë në ambient të mbyllur, si në çerdhe apo shkolla fëmijët infektohet njëri nga tjetri, njofton Portalb.

“Muajin e kaluar, ka pasur rritje të vogël të rasteve të “Variçelës” (e njohur në popull si “lia e dheneve”), por ajo nuk është diçka mjaft serioze sepse tani është sezoni për këtë sëmundje”, thonë nga Qendra për Shëndet Publik-Shkup, pasi që Qendra për Shëndet



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Publik e Kumanovës ka deklaruar se në Kumanovë është rritur numri i fëmijëve të prekur nga kjo sëmundje.

“Ka “Variçela”, por ajo nuk është diçka shqetësuese. Sezoni ka filluar diku në tetor-nëntor, ndërkaq dihet se ajo shpërndahen në hapësira të mbyllura. Vjet kemi pasur 1.743 të prekur, që është dy herë më pakë se në vitin 2014 në të cilin vit janë regjistruar 3.085 të prekur. Presim që të rritet pasi që të mbarojë pushimi dimëror, gjegjësisht pasi që të fillojnë me punë shkollat”, thotë Lile Lazarevska, epidemiolog në Qendrën për Shëndet Publik-Shkup, njofton Portalb

Në Kumanovë në dhjetorë janë evidentuar 86 të prekur, në nëntor 37, ndërkaq në tetor a pasur vetëm 20 të prekur nga “Variçela”. Numri më i madh i të sëmurëve janë fëmijët e moshës parashkollore, por edhe nxënësit deri në 9 vjet.

Ky virus manifestohet me paraqitjen e puçrrave të cilat fillojnë nga barku, përhapen në kokë, duar dhe këmbë. Të njëjtat transformohen në flluska uji. Periudha e inkubacionit është prej 10 deri më 20 ditë. Epidemiologët thonë që fëmijët e prekur nga “Variçela”, duhet të kenë kujdes për higjienën personale, t'i lajnë duart shpesh dhe 2 deri më 3 javë të qëndrojnë në shtëpi. /Portalb